

Specifikime Teknike

**Projekti : " Rikonstruktion i rruges
Gonice "**

Tirane 2008

Përmbajtja

I.a. Punime betoni	2
1/1, 1/2 Prishje totale	Error! Bookmark not defined.
2/3. Gërmim dheu seksion i detyruar :	3
2/4. Ndertim bankina anesore :	3
2/5. Gërmim dheu seksion i lire:	3
2/6. Mbushje me material shkembor :	3
3/7. Shtrese zhavori nen kunete:	Error! Bookmark not defined.
3/8. Beton M-200 per kunete :	4
3/9. F.V Bordura betoni te Parapregaditura 20x30x100 cm :	Error! Bookmark not defined.
3/10. Mure betoni M-150 :	4
3/13, 4/17. Beton M-100 nen bordura e tubat e betonit :	Error! Bookmark not defined.
4. Punime Tombino ne Rruge :	4
4/14. Gërmim dheu per kanalet :	4
4/15. Shtrese zhavori nen tuba :	4
4/16. Shtrese rere nen, anash dhe mbi tuba :	4
4/18. Mbushja e kanaleve me zhavor :	5
4/22. F.V. tuba betoni, d=400 mm :	5
4/23. F.V. tuba b/a, d=600 mm :	5
5/25, 26. Shtrese cakulli makinerie, 1x15 cm, gran.10/60 mm, 5/50 mm :	5
5/27.Shtrese stabilizanti 1x10cm,gran.5/35mm:	6
5/28. Shtrese binderi me trashesi 6 cm :	6
5/29. Shtrese asfaltbetoni me trashesi 4 cm :	6

I. Paraqitje

Ky 'Specifikim Teknik', si dokument kontraktual, eshte hartuar enkas nga grupi i projektimit per projektin "Projekti Rikonstruksion i rruges Gorice", Komuna Suke. Zerat e rradhitura ne permbajtje, jane pjese dhe pershkrime te detajuara te vizatimeve te bera nga projektuesit. Standartet e perdorura ne kete 'Specifikim Teknik', nuk kane qene mbeshitetur vetem ne vizatimet por dhe ne manuallet ligjore dhe libra te tjere keshillues si:

- Manuali nr.1 i "Analizat Teknike per prodhimin e materialeve te ndertimit, udhezime dhe kritere"

Tirane - Dhjetor 1992 (Republika e Shqiperise - Ministria e Ndertimit),

Projektimi i Betoneve te Zakonshme, K.T. 37-75,

Tirane - 1980 (Republika e Shqiperise - Ministria e Ndertimeve I.S.P.Nr. 1).

Raporte e meposhtme per betonin, perdorur ne punimet e ndertimit dhe referuar zerave specifike, jane te vleshme per 1(nje) m³ volum beton me çimento te zakonshme Portland. Këto standarte bazohen ne broshuren "Projektimi i Betoneve te Zakonshme, K.T. 37-75",

Tirane 1980 (Republika e Shqiperise - Ministria e Ndertimeve I.S.P.Nr. 1)

II. Betoni

(Sasia per 1 m³)

I.a. Punime betoni

I.a.1 Beton marka 100 me *inerte*, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e lare me modul 2,6: Çimento 300 kg 240 , rërë e lare m³ 0,45 , granil m³ 0,70 , uje m³ 0,19 .

I.a.2 Beton marka 150 me *inerte* , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e lare me modul 2,6: Çimento 400 kg 260 , rërë e lare m³ 0,44 , granil m³ 0,70, uje m³ 0,18.

I.a.3 Beton marka 200 me *inerte* , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e lare me modul 2,6: Çimento 400 kg 300 , rërë e lare m³ 0,43 , granil m³ 0,69 , uje m³ 0,18 .

2. Punime ne rruge :

2/3. Gërmim dheu seksion i detyruar :

Gërmim dheu per trupin e rruges, deri në thellesine 50, ne truall te çfarëdo natyre dhe konsistence, te thare ose te lagur (argjile edhe n.q.s. eshte kompakte, rërë, zhavorr, gure etj.), përfshirë prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trunqjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m³, plotesimin e detyrimeve ne lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave te zeza, te bardha ujesjellesit, te elektrikut ne pergjithesi etj.,

2/4. Ndertim bankina anesore :

Ky ze perfshin te gjitha proceset dhe materialet qe duhen per ndertimin e bankines uniforme me trashesi 15 cm te cakullit. Ne te perfshihet kostoja e blerjes se materialit, furnizimi, transporti, depozitimi dhe shtimi dhe nivelimi me grejder dhe cilindrimi me 5 – 6 kalime vajtje ardhje deri ne ngjeshje 98%. Cakulli duhet te jete nga thyerja e gurit te kavos me granulometri 5/40 mm, te behen provat e materialit per plotesimin e kushteve teknike per materialin qe perdoret dhe me pas te lajmerohet perfaqesuesi i Investitorit. Vetem pas miratimit me shkrim nga Supervizori do te lejohet perdorimi i materialit te cakullit per bankinat. Çmimi i referohet 1 m² shtrese me cakulli 1x15 cm, gran.5/40 mm.

2/5. Germim dheu seksion i lire:

Ky çmim perfshin teresine e puntorise dhe punimeve qe lidhen me germimin per profilimin e trupit te rruges, pamvaresisht ne se ky germim behet me krahe, me makineri apo me mina, ne prezence apo te ujit, ne seksion te detyruar apo jo, ne toke te forte apo te bute, zhavorr, beton apo asfalt. Gjithashtu ketu duhet te futet edhe kostoja e ngarkimit, transportit, shkarkimit, ne vendet e autorizuara nga bashkia, te materialeve qe dalin nga germimi. Ky çmim i referohet 1 m³.

2/6. Mbushje me material shkembor :

Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhen me mbushjen me material shkembor per profilimin e trupit te rruges dhe te trotuareve ne thellesine e dhene ne profilat terthore te projektit me shtresa çdo 20 cm, grejderimin dhe rulimin ne lageshtire te ketij materiali. Gjithashtu ketu futet dhe kostoja e blerjes/prodhimit, ngarkimit, transportit, shkarkimit, te materialeve te nevojshme. Ky çmim i referohet 1 m³.

3. Punime Betonesh ne rruge:

3/8. Beton M-200 :

Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhet me blerjen e betonit ose te materialeve dhe prodhimin e betonit M-200 per kuneten, germimi i seksionit ku do te hidhet kuneta, ngarkimin, transportin, shkarkimin, hedhjen ne veper, pregatitjen e armatures se derrases, vibrimin e tij, te gjitha keto konform vizatimit tip shoqerues ne projekt. Betonet duhet te jene me dozim sipas pikes I.a.3. Ky cmim i referohet. 1 m^3 .

3/10. Mure betoni M-150 :

Themeli i murit dhe muri ne lartesi prej betoni, me beton m-150, me dozim te betonit per m^3 si pika 1.a.2, duke përfshirë kallepet, perforcimet dhe çdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e themeleve dhe realizimin e tyre ne menyre perfekte.

4. Punime Tombino ne Rruge :

4/14. Germim dheu per kanalet :

Me zerin nenkuptojme germimin e seksionit te kanalit ne thellesine e kerkuar ne projekt, me krahe apo makineri, sipas rastit, perfshi ketu thyerjen e shtresave te betoneve apo asfalteve, evadimin e materialeve te teperta jashte objektit dhe cdo shpenzim tjeter qe ka te beje me realizimin e punimeve te germimit. Te perdoret kallepi aty ku eshte i nevojshem. Ky cmim i referohet 1 m^3 .

4/15. Shtrese zhavori nen tuba :

Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhet me blerjen e zhavorit, hedhjen e saj ne shtresa me $t = 10 \text{ cm}$, nen tuba ku te kihet kujdes qe te respektohet granulometria dhe dhenia e pjerrtesise dhe cdo gje tjeter e nevojshme. Po ketu duhet te futet edhe kostoja e ngarkimit, transportit, shkarkimit ne objekt te zhavorit. Ky çmim i referohet 1 m^2 .

4/16. Shtrese rere nen, anash dhe mbi tuba :

Ky cmim perfshin teresine e punimeve qe lidhen me blerjen e materialit te reres, te puntorise per hedhjen ne veper, shtrirjen me trashesine dhe pjerrtesine e kerkuar, ngjeshjen me kujdes te shtreses poshte anash, mbi me trashesi 10 cm mbi tubat sipas projektit dhe kushteve teknike, ne cmim perfshihet ngarkimi, transporti, shkarkimi i materialit ne objekt dhe ngjeshja me kujdes e

teres me qellim qe tubat te mos demtohen nga agjentet mekanik. Ky çmim i referohet 1 m^3 .

4/18. Mbushja e kanaleve me zhavor :

Me zerin nenkuptojme mbushjen e seksionit te kanalit pjeserisht me zhavorr 0-25 te hedhur mbi dheun e ngjeshur pa guricka (sipas seksionit tip te dhene ne projekt), pas montimit perfundimtar te linjes. Ky çmim i referohet 1 m^3 .

4/22. F.V. tuba celiku $d=300 \text{ mm}$:

Ky çmim perfshin teresine e puntorise dhe punimeve qe lidhen me blerjen e tubave te celikut ($d=300 \text{ mm}$, te cilat duhet te jene me spesor 5mm), blerjen e zhavorit, dhe cdo gje tjeter, vendosjen te tubave, te gjitha keto konform vizatimit tip shoqerues ne projekt si dhe ngarkimin, transportin, shkarkimin e te gjitha materialeve te permendura me siper, largimin e materialeve te teperta ne pikat e autorizuar nga autoritetet lokale per hedhjen e mbeturinave ndertimore, dhe çdo gje tjeter qe lidhet me realizimim e ketij zeri sipas projektit. Ky çmim i referohet 1 ml .

4/23. F.V. tuba b/a, $d=600 \text{ mm}$:

Ky çmim perfshin teresine e puntorise dhe punimeve qe lidhen me blerjen e tubave b/a ($d=600 \text{ mm}$, te cilat duhet te jene me koka femer mashkull), blerjen e llacit te cimentos, zhavorr, dhe cdo gje tjeter, vendosjen dhe bashkimin koke me koke te tubave me llac cemento, te gjitha keto konform vizatimit tip shoqerues ne projekt si dhe ngarkimin, transportin, shkarkimin e te gjitha materialeve te permendura me siper, largimin e materialeve te teperta ne pikat e autorizuar nga autoritetet lokale per hedhjen e mbeturinave ndertimore, dhe çdo gje tjeter qe lidhet me realizimim e ketij zeri sipas projektit. Ky çmim i referohet 1 ml .

5. Punime Shtresash ne rruge:

5/25, 26. Shtrese cakulli makinerie, $1 \times 15 \text{ cm}$, gran.10/60 mm, 5/50 mm :

Ky ze perfshin teresine e punimeve qe lidhen me shtresen e cakullit, $1 \times 15 \text{ cm}$ me qellim perforcimin e trupit te rruges ne drejtimin terthor dhe gjatesor sipas profileve perkatese te projektit si dhe rulimin dhe ngjeshjen e shtreses se cakullit deri ne densitet 95% . Per shkak te gjendjes jo uniforme te siperfaqes egzistuese te rruges. Ne tere siperfaqen eshte parashikuar perdorimi i grejderit me qellim perpunimin me te mire te siperfaqes se rruges dhe rulimi i shtreses me rul 10- 12

ton me 5 – 6 kalime vajtje ardhje. Granulometria duhet te jete jo me shume se 10/60 mm, 5/50 mm, cakulli qe do te perdoret duhet te miratohet paraprakisht me shkrim nga perfaqesuesi i Investitorit dhe Supervizori. Ky material duhet te plotesoje kushtet teknike per qelimin e perdorimit dhe te mos kete me shume se 5% argjila. Ky cmim i referohet 1 m².

5/27. Shtrese stabilizanti 1x10cm, gran. 5/35mm:

Ky ze perfshin te gjitha proceset dhe materialet qe duhen per ndertimin e shtreses uniforme me trashesi 10 cm te stabilizantit, pas perfundimit te shtreses paraardhese te themelit te rruges. Ne te perfshihet kostoja e blerjes se materialit, furnizimi, transporti, depozitimi shtrimi dhe nivelimi me grejder dhe cilindrimi me 5 – 6 kalime vajtje ardhje deri ne ngjeshje 98%. Stabilizanti duhet te jete nga thyerja e gurit te kavos me granulometri 5/35 mm, te behen provat e materialit qe perdoret per plotesimin e kushteve teknike, per materialin qe do te perdoret te lajmerohet perfaqesuesi i Investitorit. Vetem pas miratimit me shkrim nga Supervizori do te lejohet perdorimi i materialit te stabilizantit. Çmimi i referohet 1 m².

5/28. Shtrese binderi me trashesi 5 cm :

Ky çmim perfshin koston per blerjen e materialit, furnizimin, shperndarjen e binderit ne nje shtrese uniforme me trashesi 6 cm dhe cilindrimin e tij, pas perfundimit te shtreses uniforme e ngjeshur dhe profiluar mire dhe sipas projektit e stabilizerit ne te gjithe siperfaqen e rruges me makineri, si dhe pastrimi nga papasterite e mundshme qe te realizohet bashkimi i saj me shtresen e re. Para shperndarjes se binderit duhet te behet sperkatja e siperfaqes me prajmer 0,5 litra/m². Sasia e binderit duhet te jete e tille qe te siguroje pas rulimit trashesine minimale te percaktuar ne projekt (6 cm). Shtrimi duhet te behet me makine asfaltoshtruese. Binderit ne objekt duhet te kete granulometrine, temperaturen dhe konsistencen e duhur. Pas shperndarjes binderit duhet te rulohet duke krijuar nje siperfaqe konform prerjes terthore dhe pjerrësive te dhena ne projekt. Pas rulimit behet pastrimi i siperfaqes se rruges nga mbeturinat. Anet e shtreses se binderit duhet te realizohen me ane te drejtuesve per te ruajtur linearitetin e tyre si dhe rrezet e kurbaturave ne kthesa. Ne kete çmim futet dhe çdo gje tjeter qe lidhet me kete operacion. Çmimi i referohet 1 m².

5/29. Shtrese asfaltobetoni me trashesi 3 cm :

Ky çmim perfshin koston e blerjes se materialit, furnizimin, transportin, shperndarjen dhe rulimin e asfaltobetonit ne nje shtrese me trashesi 4 cm. Paraprakisht duhet te behet pastrimi i siperfaqes nga te gjitha mbeturinat. Para shperndarjes se asfaltobetonit duhet te behet sperkatja e siperfaqes me prajmer 0,5 litra/m². Sasia e asfaltobetonit duhet te jete e tille qe te siguroje pas rulimit trashesine uniforme te percaktuar ne projekt (4 cm). Asfaltobetoni ne objekt duhet te kete granulometrine, temperaturen dhe konsistencen e duhur. Pas shperndarjes, asfaltobetoni duhet te rulohet duke krijuar nje siperfaqe

konform prerjes terthore dhe pjerresive te dhena ne projekt. Shtrimi duhet te behet me makine asfaltoshtruese. Pas rulimit behet pastrimi i siperfaqes se rruges nga mbeturinat si dhe pastrimin i mbetjeve te asfaltobetonit mbi kuneten e betonit per te realizuar nje vije te dukshme. Ne kete çmim futet dhe çdo gje tjeter qe lidhet me kete operacion. Anet e shtreses se asfaltobetonit duhet te realizohen me ane te drejtuesve per te ruajtur linearitetin e tyre si dhe rrezet e kurbaturave ne kthesa. Çmimi i referohet 1 m².

Studio Projektuese

"DERBI - E"

Ing. Bexhet Dedja



